



MONITORIMI I DEZINFORMIMIT

RAPORT TRE-MUJOR
Prill – Qershor

PËRGATITUR NGA
Sbunker


2026
JULY

www.sbunker.org

PËRMBLEDHJE

Periudha prill-qershor 2026 u karakterizua nga vazhdimësia e narrativave dezinformuese të lidhura me zhvillimet politike në Kosovë. Në fokus ishin propaganda mbi faktorët që çuan në krizën politike, manipulimi digjital dhe përdorimi në rritje i përmbajtjeve të gjeneruara me Inteligjencë Artificiale (IA). Analiza e kësaj periudhe tregoi se dezinformatat nuk u kufizuan vetëm në çështjet politike, por u shtrinë edhe në temat e sigurisë, funksionimin e institucioneve shtetërore dhe procesin zgjedhor.

Përmbajtjet e monitoruara u karakterizuan nga përdorimi i narrativave emocionale dhe polarizuese, të ndërtuara për të nxitur pasiguri dhe për të ndikuar në perceptimin e opinionit publik, veçanërisht në prag të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare të 7 qershorit. Pas përfundimit të mandatit të presidentes Vjosa Osmani dhe dështimit të Kuvendit për zgjedhjen e pasardhësit të saj, u shtuan pretendimet manipuluese që në disa raste lidhnin zhvillimet politike me kërcënime ndaj sigurisë kombëtare dhe me ndikimin e aktorëve të huaj, kryesisht Serbisë dhe Rusisë.




Gjatë fushatës zgjedhore u evidentuan gjithashtu dezinformata që lidheshin me sondazhet mbi mbështetjen elektorale të partive politike, si dhe narrativa manipuluese për ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Në veçanti, Ligji për Shtetësinë u përdor për të promovuar pretendime mbi gjoja "kolonizim" të Kosovës me serbë.

Gjatë periudhave zgjedhore gjithnjë e më shpesh po përdoren fëmijët në aktivitetet dhe materialet promovuese të partive politike. Fotografitë dhe videot me të mitur u publikuan fillimisht nga partitë politike në rrjetet sociale e më pas u shpërndanë gjerësisht edhe nga mediat, duke rritur dukshëm ekspozimin e tyre në hapësirën publike.

Po ashtu, u identifikuan narrativa që paraqisnin forcimin e bashkëpunimit të Kosovës me NATO-n si dëshmi të përgatitjeve për konflikte të reja ose si argument për pretendime të pabazuara mbi shkeljen e të drejtave të komuniteteve joshumicë.

Paralelisht, vazhduan mashtrimet përmes mesazheve SMS, të cilat synonin përdoruesit e telefonive mobile në Kosovë përmes skemave të phishing-ut, me qëllim vjedhjen e të dhënave personale.



KRIZA POLITIKE SI KATALIZATOR I DEZINFORMATAVE

Prill 2026



Dështimi i zgjedhjes së presidentit/es së ri dhe shpallja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme krijuan një mjedis të favorshëm për intensifikimin e dezinformatave në hapësirën digjitale. Gjatë kësaj periudhe u vu re një rritje e përdorimit të përmbajtjeve të gjeneruara me Inteligjencë Artificiale (IA), të cilat synonin kryesisht figurat politike dhe proceset institucionale.

Një nga rastet e demaskuara ishte publikimi i një balline të fabrikuar që e lidhte kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, me Beogradin. Verifikimi tregoi se materiali ishte plotësisht i manipuluar dhe nuk kishte origjinë nga ndonjë media kredibile në Kosovë apo rajon. Ky rast illustroi mënyrën se si fotografitë dhe ballinat e falsifikuara vazhdojnë të përdoren për diskreditimin e figurave publike dhe krijimin e perceptimeve të rreme.

Paqëndrueshmëria politike u shfrytëzua gjithashtu për rikthimin e narrativave që lidhen me sulmin terrorist në Banjskë. Kanale pro-serbe dhe pro-ruse në Telegram promovuan pretendime për një "akt të dytë", ndërsa përmes postimeve emocionale glorifikuan organizatorët e sulmit dhe shmangën përgjegjësinë për ngjarjen.

Paralelisht, propaganda pro-ruse e paraqiti Kosovën si një shtet të paqëndrueshëm dhe jofunksional, duke manipuluar zhvillimet rreth përfundimit të mandatit të Presidentes së Kosovës. Këto pretendime u përdorën për të krijuar përshtypjen e mungesës së legjitimitetit shtetëror, ndonëse nuk mbështeten në asnjë bazë juridike apo kushtetuese. Një tjetër narrativë e fabrikuar lidhej me pretendimet se pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës do të dërgohen në Gaza ani se nuk njihen ndërkombëtarisht pas krijimit të të ashtuquajturit Bord i Paqes nga Presidenti amerikan Donald Trump. Ky pretendim u riciklua nga media proqeveritare serbe dhe rrjete të tjera propagandistike, duke synuar diskreditimin e institucioneve të sigurisë së Kosovës përmes një zinxhiri të koordinuar dezinformimi. Po ashtu, Sbunker publikoi analiza mbi ndikimin afatgjatë të Kinës në Kosovë, duke shqyrtuar përdorimin e instrumenteve të fuqisë së butë, bashkëpunimit ekonomik dhe ndikimit informativ si pjesë e strategjisë së Pekinit në rajon. Vëmendje iu kushtua edhe zhvillimeve të lidhura me Inteligjencën Artificiale, duke analizuar potencialin e saj si për prodhimin e informacionit, ashtu edhe rreziqet që paraqet përmes krijimit të dezinformatave dhe manipulimeve vizuale.




DEZINFORMATAT E LIDHURA ME ZGJEDHJET

Maj 2026

Gjatë muajit maj, dezinformatat u përqendruan kryesisht te zhvillimet politike dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, duke synuar ndikimin në perceptimin e qytetarëve përmes sondazheve të fabrikuara, përmbajtjeve të manipuluar dhe materialeve të gjeneruara me Inteligjencë Artificiale (IA). Hapësira informative u karakterizua nga qarkullimi i pretendimeve të pabazuara, të cilat shfrytëzonin klimën politike për të krijuar paqartësi dhe për të ndikuar në debatin publik.

Një nga fenomenet më të përhapura ishte publikimi i sondazheve të rreme, të paraqitura si matje të opinionit publik, por pa burime, metodologji apo transparencë mbi mënyrën e realizimit të tyre. Të shpërndara kryesisht në rrjetet sociale, këto materiale synonin të krijonin perceptime të rreme mbi mbështetjen elektorale të subjekteve politike dhe të ndikonin në sjelljen e votuesve në prag të zgjedhjeve.



Përveç sondazheve, u evidentuan edhe publikime me tituj sensacionalë dhe përmbajtje të nxjerra jashtë kontekstit, të cilat shfrytëzonin fragmentimin e informacionit për të nxitur polarizimin politik dhe për të shtrembëruar kuptimin e zhvillimeve aktuale.

Një prire tjetër e rëndësishme ishte rritja e përdorimit të Inteligjencës Artificiale në krijimin e përmbajtjeve mashtruese. Gjatë monitorimit u identifikuan fotografi, video dhe materiale të tjera të gjeneruara me IA, të cilat paraqisnin si reale ngjarje ose deklarata që nuk kishin ndodhur. Kjo dëshmoi se teknologjitë gjenerative po përdoren gjithnjë e më shumë për t'u dhënë besueshmëri dezinformative dhe për ta bërë më të vështirë dallimin mes përmbajtjes autentike dhe asaj të fabrikuar.



Një nga rastet e demaskuara ishte një video e krijuar me Inteligjencë Artificiale, në të cilën pretendohet në mënyrë të rreme se qytetarët shprehnin opinionet e tyre për ish-presidenten Vjosa Osmani. Verifikimi tregoi se materiali ishte tërësisht i gjeneruar me IA dhe përbënte një shembull konkret të përdorimit të teknologjive gjenerative për fabrikimin e deklaratave që imitojnë persona realë.

Në përgjithësi, monitorimi i muajit maj konfirmoi se dezinformimi po evoluon krahas zhvillimit të teknologjisë, duke kombinuar manipulimin e proceseve politike me përdorimin gjithnjë e më të sofistikuar të Inteligjencës Artificiale.

NARRATIVAT GJEOPOLITIKE


Qershor 2026

Muaji qershor u karakterizua nga ndërthurja e narrativave gjeopolitike, dezinformatat që lidhen me zhvillimet e brendshme dhe çështjet e sigurisë në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe u identifikuan pretendime të pabazuara që synonin të shtrembëronin perceptimin e qytetarëve mbi proceset institucionale, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe stabilitetin rajonal. Krahas tyre, vazhduan edhe mashtrimet digjitale që kishin në shënjestër qytetarët.

Një nga temat ishte debati rreth Ligjit për Shtetësinë. Ndryshimet kanë nxitur debat dhe reagime të shumta të cilat u bënë edhe në kontekst të fushatës elektorale për zgjedhjet e 7 qershorit.

Pretendimet e ngritura janë se ndryshimet e propozuara nga Qeveria e Kosovës i hapin rrugë “kolonizimit” nga ana e serbëve dhe se prapa kësaj ekziston një “marrëveshje sekrete” ndërmjet kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit serb, Aleksandar Vučić. Deri tash nuk është publikuar ndonjë dokument, marrëveshje apo provë konkrete që e mbështet këtë pretendim.


Për llogari të fushatës elektorale, partitë politik nuk i kursyen as fëmijët. Rasti që nxiti reagime të shumta ishte përdorimi i një vajze në tubimin e Lëvizjes Vetëvendosje në Vushtrri. Aktiviteti elektoral ku mori pjesë kryeministri në detyrë, Albin Kurti, u shoqërua me një skenë që ngre shqetësime serioze për mënyrën se si politika po i përdorë fëmijët. Një vajzë e mitur, para syve të Kurtit recitoi një poezi që përmbante sulme ndaj opozitës dhe lavdërime për liderin e partisë.




Në planin gjeopolitik, u përhapën pretendime se NATO po e armatos Kosovën për ta përgatitur për konflikte të reja në rajon. Përmbajtjet manipuluese i paraqitën takimet ndërmjet zyrtarëve të NATO-s dhe atyre të Kosovës si dëshmi të përgatitjeve për luftë, duke i nxjerrë ato jashtë kontekstit dhe duke promovuar narrativa që synojnë të krijojnë frikë, pasiguri dhe përçarje mes komuniteteve.

Përveç dezinformatave politike dhe gjeopolitike, monitorimi evidentoi vazhdimësinë e mashtrimeve përmes mesazheve SMS. Të maskuara si komunikime nga institucione publike ose kompani të njohura, këto mesazhe synonin t'i nxisnin qytetarët të hapnin lidhje të dyshimta ose të ndanin të dhëna personale dhe financiare. Përsëritja e këtyre skemave konfirmon se phishing-u mbetet një nga format më të përhapura të manipulimit digjital, me pasoja të drejtpërdrejta financiare dhe të sigurisë për qytetarët.

Në përgjithësi, nga monitorimi i muajit qershor përmbajtjet e analizuara synuan të krijojnë konfuzion rreth zhvillimeve institucionale dhe çështjeve të sigurisë, ndërsa njëkohësisht shfrytëzuan metoda të sofistikuara për manipulimin dhe mashtrimin e qytetarëve në hapësirën digjitale.




NARRATIVAT DOMINUESE TË DEZINFORMIMIT




Analiza më e fundit, mbështetur në një bazë të dhënash me më shumë se 6,000 raste dezinformimi, zbardh se si manipulimi i informacionit ka evoluar në një sistem të sofistikuar ndërkufitar të ndikimit hibrid.

Më shumë: [Geopolitics of information threats in the Western-Balkans](#)

DEZINFORMATAT MË TË ZAKONSHME NË KOSOVË



TEMAT



FACT-CHECK: SI PO E SH TREMBËRON "PRAVDA" SITUATËN POLITIKE NË KOSOVË

PRETENDIMI Sistemi politik u shkatërrua, Kosova kuazi shtet

Mandati i Vjosa Osmanit ka përfunduar sipas afatit kushtetues

Albulena Haxhiu ushtron përkohësisht detyrën – procedurë normale

Gjykata Kushtetuese ka:

FACTS

- ✓ Përcaktuar afate të reja
- ✓ Sqaruar procedurat për zgjedhje ose shpërndarje të Kuvendit

S' SBUNKER

PËRFUNDIME

Monitorimi i periudhës prill-qershor 2026 tregon se hapësira informative në Kosovë vazhdoi të karakterizohej nga një nivel i lartë i përmbajtjeve dezinformuese, të përqendruara kryesisht në zhvillimet politike, zgjedhjet, çështjet e sigurisë dhe temat me ndjeshmëri historike. Gjatë këtij tremujori u evidentua përdorim më i madh i teknikave të manipulimit digjital, veçanërisht në rrjetet sociale, ku përmbajtjet synonin të ndikonin perceptimin e qytetarëve dhe të krijojnë konfuzion rreth zhvillimeve aktuale.

Një nga prirjet kryesore ishte instrumentalizimi i proceseve politike për prodhimin dhe shpërndarjen e dezinformatave. Përmbajtjet manipuluese u fokusuan në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, publikimin e sondazheve të rreme, keqinterpretimin e ndryshimeve në Ligjin për Shtetësinë, si dhe në narrativa që lidhnin bashkëpunimin e Kosovës me NATO-n me pretendime të pabazuara për përshkallëzim të situatës së sigurisë. Krahas tyre, u rikthyen edhe narrativa propagandistike që shfrytëzonin tema historike dhe identitare për të nxitur polarizim dhe mosbesim ndaj institucioneve.


Monitorimi evidentoi gjithashtu rritjen e rolit të Inteligjencës Artificiale në prodhimin e përmbajtjeve manipuluese. Fotografitë, videot dhe materialet e gjeneruara me IA u përdorën për të fabrikuar deklaratë, ngjarje dhe identitete të rreme, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë dallimin ndërmjet përmbajtjes autentike dhe asaj të manipuluar. Ky zhvillim konfirmon se teknologjitë gjenerative po shndërrohen në një nga sfidat kryesore për integritetin e informacionit në hapësirën digjitale.

Përveç dezinformatave me karakter politik dhe gjeopolitik, gjatë periudhës së monitorimit vazhduan edhe mashtrimet digjitale, veçanërisht përmes mesazheve SMS dhe skemave të phishing-ut, të cilat synonin vjedhjen e të dhënave personale dhe financiare të qytetarëve.

Kjo dëshmon se ekosistemi i manipulimit informativ nuk synon vetëm ndikimin mbi opinionin publik, por edhe përfitime të drejtpërdrejta përmes aktiviteteve mashtruese.

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se dezinformimi në Kosovë po bëhet gjithnjë e më kompleks, duke kombinuar propagandën politike, manipulimin vizual, përmbajtjet e gjeneruara me Inteligjencë Artificiale dhe mashtrimet digjitale. Ky kombinim rrit rrezikun për polarizimin e debatit publik, cenimin e besimit në institucionet demokratike dhe dobësimin e aftësisë së qytetarëve për të dalluar informacionin e vërtetë nga manipulimi.

Në këtë kontekst, forcimi i mekanizmave të verifikimit të fakteve, zhvillimi i edukimit medial dhe digjital mbeten elemente kyçe për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit. Po aq i rëndësishëm është edhe zhvillimi i kapaciteteve për identifikimin e hershëm të përmbajtjeve të gjeneruara me Inteligjencë Artificiale, të cilat pritet të kenë ndikim gjithnjë e më të madh në mjedisin informativ në periudhat e ardhshme.



WESTERN BALKANS ANTI-DISINFO HUB



Programi Disinfo, i lansuar në vitin 2022, përfaqëson një nga nismat më të rëndësishme të Sbunker-it. Si pjesë e Western Balkans Anti-Disinformation Hub, Disinfo monitoron në baza ditore përmbajtjet mediale dhe publikon artikuj verifikues (fact-check) që demaskojnë pretendimet e rreme nga aktorë keqdashës, si vendorë ashtu edhe të huaj.



NA KONTAKTONI



Adresa: Rr. "Rexhep Mala" nr.11, Prishtinë 10000 Kosovë.

info@sbunker.net

www.sbunker.org

